

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/1-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, Kolegji i përbërë prej gjyqtarëve, Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapić, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **palës ankuese**:

D. S. J., me vendbanim, Beograd, Serbi

Kundër:

B. E., me vendbanim në ...

Palë përgjegjëse në AKP/ Palë përgjegjëse në ankesë/

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, nr. KPCC/D/C/240/2014, të datës 30 Prill 2014, (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave me numër KPA14023), pas shqyrtimit të mbajtur me datë 12 Shkurt 2020, bien:

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e D. J., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/C/240/2014, të datës 30 Prill 2014, për sa i përket kërkesës, të regjistruar në AKP, me numër KPA14023.**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/C/240/2014, i datës 30 Prill 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP, me numër KPA14023.**

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Me datë 10 Gusht 2006, D. J., (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP), për mes të cilës kërkon vërtetimin e të drejtës pronësore dhe kthimin e posedimit të lokalit afarist në sipërfaqe prej 65 m² i cili gjendet në rrugën, “...”, i regjistruar në ngastrën kadastrale me numër ..., Zona kadastrale, Prizren, (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar).
2. Sipas palës ankuese pronën lëndore e ka trashëguar nga nëna e saj D., të njëjtin e ka shfrytëzuar deri në mesin e muajit Qershor 1999, kur është detyruar ta braktisë si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999, në Kosovë.

3. Në mbështetje të kërkesës, pala ankuese në AKP, kishte dorëzuar dokumentet si në vijim;
 - Përshkrimin e Listës Poseduese Nr. ..., të lëshuar nga Zyra kadastrale e Prizrenit, e dislokuar në Serbi, që dëshmon se ngastra kad. nr. ..., është e evidencuar në emër të D.J.,
 - Aktvendimin mbi Trashëgiminë, T. Nr.99/2001, të dt. 18 Maj 2001, që dëshmon se pas vdekjes së D. J., me 11.08.1999, pasuria e paluajtshme, përfshirë ngastrën kadastrale nr..., i bartet palës ankuese,
 - Letërnjoftimin të lëshuar nga organet paralele të Prizrenit ,në emër të palës ankuese me 3 Dhjetor 1999.

4. Më 3 Qershor 2010, dhe 1 Gusht 2010, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, kishte bërë identifikimin e pronës së kërkuar duke e vendosur një shenjë në pronën e kërkuar, që rezultoi të ishte një lokal afarist i zënë nga B. E.,(tutje, pala përgjegjëse PP), i cili pretendoi të drejtë ligjore.

5. Pala përgjegjëse nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes në procedurë dhe deklaroi se pronën e kërkuar e ka blerë në vitin 2001 nga pala ankuese. Ai me 4 Gusht 2010, paraqiti në Sekretarinë e AKP-së, dokumentet me të cilat pretendonte pronësinë mbi pronën e kërkuar si në vijim;
 - Kontratën e shitblerjes të vërtetuar në Gjykatën Komuale në Prizren me numër, Vr. ..., të datës 22 maj 2001, të lidhur në mes palës ankuese si shitëse dhe B. E. si blerës;
 - Fletën Poseduese, dhe Kopjen e planit, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit me 30 Korrik 2001, që dëshmon se mbi bazën e kontratës së shitblerjes, janë bërë ndryshimet në kadastër dhe prona e kërkuar është regjistruar në emër të palës përgjegjëse.
 - Certifikatë Pronësie të datës 22 Korrik 2009, me të cilën dëshmohet se prona e kërkuar ishte e evidentuar në emër të B. E.
 - Aktvendimin nr. ..., datë 23 tetor 2009, sipas të cilit palës përgjegjëse i lejohej të rrënojë objektin e vjetër në pronën e kërkuar .

6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte arritur të verifikonte pozitivisht dokumentet me të cilat pala ankuese e mbështeste kërkesën e saj, por edhe dokumentet me të cilat dëshmohet tjetërsimi i pronës ishin gjetur dhe verifikuar pozitivisht.

7. Pas ballafaqimit me dëshmitë e PP, pala kërkuese, (tani ankuese), gjatë kontakteve i kishte konfirmuar sekretarisë së AKP-së, se ajo ia kishte shitur pronën e kërkuar palës përgjegjëse në bazë të një para kontrate jo zyrtare në vitin 1999 dhe kontratës zyrtare në vitin 2001, por e njëjta kishte deklaruar se nuk ishte e kënaqur me çmimin e shitjes së pronës dhe tani kërkonte kompensim.

8. Më 30 Prill 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimin e vet KPCC/D/C/240/2014, vendosi që kërkesa të hedhet, sipas arsytimit në paragrafin 39, të vendimit ndër të tjera theksohej se, “paraqitësi i kërkesës ka dështuar që të dëshmoi se humbja e posedimit lidhet me rrethanat e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në vitin 1998/99, por me tjetërsim të vullnetshëm të pronës.
9. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 20 Tetor 2015. Më 9 Nëntor 2015, pala ankuese kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme.
10. Pala përgjegjëse B. E. e kishte pranuar Vendimin me 2 Shtator 2014. Një kopje e ankesës e palës ankuese, i është dorëzuar palës përgjegjëse me 20 Shtator 2016, i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë në afatin e caktuar ligjor.

Pretendimet e palës ankuese:

11. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKKP-së përmban shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe gjithashtu vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
12. Sipas palës ankuese, dokumentet e dorëzuara dëshmojnë se prona është shitur me autorizim të falsifikuar dhe se mohon të ketë dhënë një autorizim të tillë.
13. Pala ankuese mohon shitjen e vullnetshme të pronës edhe pse sipas evidencës në shkresat e lëndës (... dt. 01.04.2014), shih faqe 65, pala kishte pohuar shitjen me një kontratë joformale në vitin 1999, dhe formalizimin e saj në vitin 2001.
14. Në fund të ankesës së saj pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme të pranojë ankesën e saj, ta prishë vendimin e KKKP-së dhe për çështjen të lëshojë një vendim të ri me të cilin do të urdhërojë kthimin e pronës palës ankuese, mbi bazën e asaj se kontrata ka të meta në vullnet.

Arsyetime ligjor:

15. Gjykata Supreme shqyrtoi Vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejshëm: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese gjeti se: Ankesa është e pranueshme sepse ajo është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 i cili parasheh që pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për Vendimin.

Meritat e ankesës

16. Vendimi i ankimuar i KKPK-së KPCC/D/C/240/2014 i datës 30 Prill 2014, është i drejtë, i ligjshëm dhe i bazuar në vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike. Gjykata Supreme vëren se vendimi i ankimuar është marrë mbi konkludimin se , pala ankuese nuk ka arritur të dëshmojë humbjen e pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë periudhës 1998-1999, sikurse parashihet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, është i drejtë dhe i bazuar.
17. Neni 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, e parashih që paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga KKPK-ja, për ri posedimin e pronës, nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e vërteton të drejtën pronësore mbi pronën e pa luajtshme **private**, por edhe që ai, apo ajo, nuk është në gjendje ta ushtrojë të drejtën e tillë pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërdrejtë me konfliktin e armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999, apo rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.
18. Kjo sepse pala ankuese kishte nënshkruar një kontratë të shitjes me palën përgjegjëse në ankesë në vitin 1999 e pavërtetuar në Gjykatë dhe Kontratës së më vonshme të shitblerjes të vërtetuar në gjykatë në vitin 2001, dhe se tani prona evidentohet në emër të palës përgjegjëse i cili i kishte bërë ndryshimet në të dhënat e kadastrit.
19. Shitjen e pronës dhe kërkesën për çmim real në vlerë të tanishme të tregut e ka konfirmuar vetë pala ankuese në bisedë me 1 Prill 2014, duke kërkuar rishikimin e çmimit blerës dhe detyrimin e palës tjetër të paguaj çmim të vlerës së tanishme të tregut .
20. KKPK-ja ka juridiksion për kërkesat për pronën e paluejtshme private dhe të drejtën e shfrytëzimit mbi pronën private për të cilat, “ humbja e posedimit e të cilave lidhet direkt me pasojat e konfliktit të armatosur ose rrethanave të lidhura me konfliktin që ka ndodhur në mes të 27 shkurtit të vitit 1998 dhe 20 Qershorit të vitit 1999”. Në qëftë se Komisioni konstaton se humbja e posedimit nuk është si pasojë e konfliktit ai e hedhë kërkesën, sipas nenit 11.4 (b), të Ligjit Nr. 03/L-079.
21. Pavarësisht pretendimeve të palës ankuese se kontrata është e lidhur pa vullnet dhe mbi bazën e dokumentave të falsifikuara, KKPK-ja ka konkluduar drejtë se kjo e bënë çështjen pa juridiksion, sepse e shëndreron në çështje kontraktuale në mes palëve, ndërsa vërtetimin apo mohimin e autenticitetit të këtyre dokumenteve, KKPK-ja, e as Gjykata Supreme nuk mund ta vërtetojnë në këtë fazë të procedurës.
22. Kjo mund të shqyrtohet dhe vërtetohet në procedurë të rregulltë në gjykatë, por përfundimisht qëndron fakti se posedimi në rastin konkret është humbur si pasojë e

transaksionit, e jo si rrethane e luftës gjë që e pamundëson veprimin e KKPK-s, apo Gjykatës në mungesë të kompetencës.

23. Ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për palët në procedurë dhe nuk paraqet pengesë për iniciimin e procedurës pranë organit apo gjykatës kompetente për palët që e konsiderojnë të nevojshme.
24. Në bazë të arsyeve të lart cekura, e në pajtim me nenin 13.3.(c) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin, nr.03/L-079, dhe nenin 195, paragrafin 1(d), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

25. Sipas nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm, dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-077/2016, me datë, 12 Shkurt 2020

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani